




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011 dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-VIII-** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **23.09.2021 (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

### R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e KK-së
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2022-2024
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullorës për taksa, ngarkesa dhe gjobë për vitin 2022
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës i Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2022
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësim-ndryshim të vendimit për shfrytëzimin e rezervës komunale me nr.01-110/05-614 i dates 30.08.2021.
6. Informat lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31.12.2020.
7. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2020.
8. Informat- raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Viti, më 16.09.2021

Kryesuesi i Kuvendit  
Naim Pira





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË SHSTATË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.08.2021 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Bajram Sokoli, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Lindita Demelezi, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, ndersa mungoi Taulant Haxhiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit.

Pasi u konstatua se kemi korum për fillimin e mbledhjes, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, dhe të gjithë të tjerët që janë prezent! Zyra Ligjore e MAPL-së naj ka konfirmu ligjshmërinë e akteve që i kemi miratu në seancën e kalume. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Jemi tu kalu me një periudhë të vështirë, ku pandemia Covid 19 po merr shumë jetra të qytetarëve tonë. Unë në emër të kuvendit komunal e në emër timin ju shpreh ngushëllime të gjithë familjarëve që kanë hup me të dashurit e tyre. Pasi që jemi në këto rrethana, ju kisha lut që të jemi sa më racional te diskutimet e tona, ta respektojmë rregulloren e kuvendit. Në këtë seancë e kemi raportin e kryetarit e ku kryetari ka pas gatishmërinë me qenë prezent sot në këtë mbledhje, po kryeministri i ka ftu urgjentisht në takim të gjithë kryetarët e komunave në ora 10, e kështu që kryetari është në atë takim, e ku ju ka pamundesu pjesëmarrja në këtë mbledhje. Unë kisha kërku, me që kemi informatën e kryetarit, që pyetjeve dhe propozimeve jashtë rendit të ditës. Ti ikim, ti ruajmë tek raporti i kryetarit. A pajtoni me këtë propozim timin.

**z.Bekim Azizi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kisha me bë pyetje, pasi që nuk është kryetari. Tu e ditë që kryetari i ka vetëm dy raporte kryesore gjatë një viti, unë nuk e shoh të arsyeshme që nënkryetarit ta prezanton në vend të kryetarit. Unë mendoj që kjo pike nuk do të jete sot hiq, le të vjen në seancën tjetër, sepse unë mendoj që duhet me qenë prezent edhe kryetari tek kjo pikë.

**z.Naim Pira, kryesuesi i Kuvendit:** Duke pas parasysh që nënkryetari i zëvendëson kryetarin në aspektin ligjor, unë mendoj që është në rregull. Kishte me qenë mirë që me vazhdu, sepse edhe tani hymë në fushatën zgjedhore, edhe nuk ka kuptim me e sjell raportin pasi që të fillon fushata.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Raporti i punës së kryetarit që e keni sot prezent, mendoj që sot duhet të diskutohet, sepse e tha edhe kryesuesi i kuvendit, në momentin e hyrjes në fushat zgjedhore, nuk e ka as një kuptim paraqitja e kryetarit, sepse është kandidat për kryetar komune për

zgjedhjet e 17 Tetorit. A bejme mire, po, edhe prezenca e kryetarit nuk mundet me e ndryshu qeta çka e ka paraqit me shkrim kryetari. Unë konsideroj që duhet me vazhdu me këtë rend dite, sepse edhe ne aspekt ligjor nuk shkelet asnjë procedurë dhe mendoj që është mirë të debatojmë sot për këtë raport, sepse edhe procesverbalet mbesin e shihet ajo që e keni diskutu ose pyet kryetarin. Po ju thamë të drejtën, përgatitja ka qenë që kryetari me qenë këtu sot, por dje në ora 5 e 2 minuta pasdite ka ardh ftesa që sot në ora 10 me qenë në mbledhje me kryeministrin, e ku shkrun që mbledhja është e rëndësishme, ku do të diskutohet për masat e Covid 19, prandaj për këtë arsye mungon kryetari sot.

**z.Jakup Demiri:** Edhe unë mendoj që kjo pik duhet të hiqet nga rendi i ditës, për shkak se kryetarin nuk e kemi këtu dhe nuk është që nuk e kemi vetëm tash, kryetari gjatë gjithë vitit asnjëherë nuk e kemi pas në kuvend. Ne deri tash nuk kemi mujt me u përball me ta, përveç mungesës së kryetarit sot mungojnë edhe kamerat, nuk kemi kamera që transmetojnë këtë mbledhje.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Qëllimi i kryetarit ka qenë që të jete sot prezent këtu, mirëpo ftesa e kryeministrit që ka ardh e ka bërë të pamundshme prezencën e kryetarit. Unë mendoj që duhet me vazhdu me këtë rend të ditës, sepse janë dokumentet, janë të shkruara dhe mundet të vazhdojmë me këtë rend dite.

**z.Jakup Demiri:** Tek puna e kamerave, transmetimi i seancave, këtë e ka rregullu edhe udhëzimi administrative edhe duhet me qenë prezent kamerat.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Jam pro kërkesës së shefit të grupit parlamentar të LVV-së dhe të PDK-së, që kjo pike e rendit të ditës të terjeket nga rendi i ditës, sepse kryetari nuk është këtu prezent.

**z.Naim Pira, Kryesues i kuvendit:** Sa i përket ingjizimit të seancave, nuk do me thanë që decitiv me qenë kamerat, këtë punë mund ta kryen edhe fajzbuku i komunës, është legjitime. Unë kam incistu nga personi kompetent nga IT-ja e komunës, që ta bënë rregullimin e teleprezences, ndërsa sa i përket kontratës, i ka skadu atij zotriut që ka qenë e ka pas me minutazh, po tani është çështje e Zyrës së Prokurimit, ndoshta në legjislaturën e re do të ketë përcjellje përmes kamerave nga televizionet.

**z.Remzi Salihu:** Sa i përket fejbukut të komunës, vërtetë e përcjelli fejbukin, aktivitetin e kuvendit ose të tjera, po mbi të gjitha menaxhimi i fajzbukit është jo i mirë. Unë nuk komentoj, po e shof që aty komentojnë njerëz të ndryshëm, edhe dikush fshihet nga komenti vetëm për një fjalë të vetme, kështu që unë jam septik në atë punën e fejbukit, e prezenca e kamerave do të ishte jo pse ne dëshirojmë me dal, po është e përcaktume me ligj, që seancat të transmetohen që të shoh publiku.

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë nuk po du me diskutu për këtë pikë, po dua të ju falënderoj që keni marr pjese në varrimin dhe në ngushëllimet përmes telefonatave, e që keni qenë fizikisht, ju falënderoj të gjithëve, por një veprim shumë të mirë që e ka bërë Qendra e Mjekësisë Familjare, kanë pas sjellje shumë të mira, kane kry pune shume të mira, nuk ka mundësi pa e përmend një falënderim të veçantë për drejtoreshën Vjollca Kadolli, e cila gjithmonë u kujdes për nënën tonë dhe e ka kry punën shumë shumë mirë. Sa i përket raporti të kryetarit, gjithherë raporti ka ardh në muajin e shtatë, kësaj here u bë për shkak të zgjedhjeve. Po unë propozoj që mos të diskutohet kjo pike fare.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Ta kemi të kuart, se shkuarja e kryetarit në Prishtinë është me plotë arsye, e kame ftesën bile, ku thotë: në pamundësi të ardhjes fizike, thotë që të hyni në mënyrë onllajn në ora 10. Nuk ka kuptim me ardh më vonë raporti, sepse me 15 shtator fillon fushata zgjedhore. Kryetari i komunës është kandidat për kryetar komune, e ma nuk ka efekt, sepse kryetari në këtë periudhë duhet me dal me fol për të ardhmen.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Nuk me mbetet tjerët, veç ta qes në votim për miratim. Kush është që të debatohet për raportin e kryetarit, ju lutem me ngritje dore? Me 10 vota pro dhe 13 kundër nuk kalon pika e raporti të

kryetarit. Ju faleminderit! Tani kaloj tek pyetjet dhe përgjigjet jashtë rendit të ditës.

**z.Bekim Azizi:** Kam pyetje lidhur me disa emëtime të cilat janë bërë në komunë. Po e kaloni katalogun e ri që është parapa me ligjin e pagave, po nuk është në fuqi dhe thjesht isha lidh me një vend të caktuar në Drejtorinë e Inspeksionit, ku në bazë të konkursit bazë të kërkesës së drejtorit të inspektorit, ka shku një inspektor i punës, ndërsa vendi i punës është hap, udhëheqës i sektorit të inspeksionit dhe në kuadër të kësaj e dimë që është bërë një aktemrim, një personi i caktuar aty dhe e kemi pas besoj që edhe drejtori edhe nënkryetari munden mu përgjigj. I kanë dy ankesa që janë bërë nga drejtori i inspeksionit, që nuk është përfill dhe nuk është respektua kjo kërkesë dhe ky në katalog nuk vlen për këta, ndërsa është vazhdu prej zyrave këtu për emërimin e tij, është fjala për shef të sektorit dhe ne e kemi inspektorin e ndërtimeve, që e ka bërë ankesa para juve dhe i është refuzu, që i njëjti nuk i ka plotësu kushtet edhe nuk është adekuat, d.m.th njerëzit që kanë qenë inspektor në këtë drejtori nuk kanë pas të drejtë mu bërë shefa të sektorëve dhe kjo thjesht është bërë ajo forma që është manipuluar ose thjesht keni punu me njerëzit të caktuar për ti qu detyrat e caktuara. Nënkryetar, cila është kjo, se edhe ti ke pas ankesën nga z.Ali, mirëpo këto ankesa kane shku edhe me lart. Edhe një pyetje tjetër: raportin e auditimit këtë vit tregon që me kontrata të veçanta janë angazhu 83 shërbime të veçanta dhe aty në raport të auditimit e cek që, 49 kontrata janë bërë pa u ndjek. Procedura e Ligji për Zyrtar Publik ne përherë kemi ngrit shqetësime për këtë.

**z.Ali Bajrami:** Pyetje për drejtorin e inspeksionit, për menaxhimin e situatës me pandemi. Udhëzimet më të reja që janë dal për situatën e krijuar, sa jeni të përgatitur me inspektor, a u përfshi edhe Komuna e Vitisë. Në mesin e këtyre inspektorëve që janë pranë për menaxhimin e kësaj situatë.

**z.Jakup Demiri:** Kam një pyetje: tek lumi "Morava", tek hidrocentrali, ne kemi mendu që i është ndalu veprimtaria, për shkak se ky hidrocentral nuk posedon as nivelin njerëzor dhe le ma tjera. Sa është e vërtetë kjo? Kam edhe një pyetje për raportin e performances: a do ta kemi në mbledhjen e radhës, pasi që nuk e kemi pas ende këtë raport?

**znj.Valbona Haziri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Në emër të Grupit të Grave anëtare të Kuvendit Komunal të Vitisë, në mënyrë që të avancojmë dhe përmirësojmë pozitën e gruas në shoqëri në Komunën e Vitisë, kërkojmë që të hapet diskutim në këtë seancë të kuvendit lidhur me hapat dhe mundësitë e zbatimit sa më të mirë të rekomandimeve tona, si: 1. Të caktohet një zyrtarë/zyrtare për buxhetim të drejtë gjinorë, me përgjegjësi të drejtpërdrejtë apo si punë shtesë nga Drejtoria e Financave, i/e cili/a në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore dhe gjitha drejtoritë komunale, do të kujdeset për monitorimin dhe mentorimin e buxhetimit të drejtë gjinorë në nivel komunal, 2. Drejtoritë komunale, të marrin obligim planifikimin dhe raportimin e buxhetit të sektorëve përkatës, ta bëjnë atë nga perspektiva gjinore, bazuar në analizë gjinore dhe statistika, duke zbatuar ligjin për Barazi Gjinore, 3. Të përmirësohet dhe avancohet roli i gruas në pozitë vendimmarrëse si dhe në sektorët ku ka numër të vogël të grave të punësuar, 4. Të përmirësohet qasja në pjesëmarrjen sa më të madhe të grave në debate publike dhe dëgjime buxhetore. Të hartohet një strategji apo një plan veprimi, i cili do të ndryshonte dhe përmirësonte këtë gjendje, në mënyrë që sa më shumë gra nga zonat rurale dhe urbane të marrin pjesë në dëgjime buxhetore apo diskutime publike (kjo mund të bëhet në bashkëpunim me shoqërinë civile apo grupet e interesit). Këto rekomandime i kemi me nënshkrimet e grave.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit:** Faleminderit Valbona për këtë iniciativë që e keni marr! Po, meqenëse jemi shume afër zgjedhjeve, mendoj që ju ka qenë dashur të jeni me aktiv më herët, e këto propozime të dhëna u kane mire që gjatë dëgjimeve buxhetore me i propozu, e në mënyrë që buxheti që do të miratohet në muajin shtator, me i pas inkorporu. Unë jam për debate, po kishte me qenë mire që ju me pas përandit si pikë të rendit të ditës për seancën e radhës, e me naj sjell materialin që mundemi me e diskutu këtë çështje, sepse konsideroj që jeni të mangët me material, sepse përndryshe unë ju përkrahi.

**z.Nuredin Lutfiu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa kërkesa nga banoret e fshatit Skifteraj. Kërkesa e parë ka të bëjë me ujësjellësin. Unë e di që para disa dite është bërë një kampanjë dhe është bërë i

funksionalizuar ujësjellësi prej pusave të “Moravës”. Sa kam unë informata, e kam thanë këtu një 8 herë me radhë, që banoret e fshatit Skifteraj nuk e pranojnë ujin nga “Morava”, ata kërkojnë një rikyqe. Kërkesë tjetër kam për kanalizimi në fshatin Skifteraj. Në disa lagje tashi nuk po funksionon. Kërkesa tjetër është mungesa e trotuarit, i cili është dëmtu shumë. Kërkesa tjetër, rruga “17 Shkurti” dhe “15 Prilli” ose lagja deri te Tuplanët, muj me shku me pa rrugën, e thamë më përgjegjësi të plotë se është rruga më e dobët në regjion të Gjilanit, nuk ka rrugë më të dëmtuara. Kam një kërkesë nga banorët e qytetit të Vitisë, rruga “14 Qershori”, të intervenohet, sepse në këtë rrugë ka dëmtime dhe të bashkëngjitet me rrugë tjetër.

**z.Zekrija Zuka:** Faleminderit kryesues! Përsëritet të nderuar të pranishëm! Unë një urim të veçantë kam për ish kolegun tim, Adnan Ymeri, të cilit ja uroj detyrën e re dhe kam një kërkesë për ta, pasi që tek çerdhja e fëmijëve po bëhet shume bërlllok dhe kërkoj që ata kontejner të largohen sa më shpejt prej aty sa nuk është infektu asnjë fëmijë, se aty edhe qentë endacak po rrinë.

**z.Remzi Salihu:** Pyetje që e kam, ka qenë e dedikume për kryetarin, po pasi që nuk është kryetari, po ja bëjë drejtorit të financave. Punëtorët me kontrata mbi vepër ka dy muaj që nuk marrin pagën. Pyetja është: pse fjala është për 20-25 punëtorë janë ofruar zgjedhjet dhe i kushtëzojnë këta punëtor nëse nuk qëndrojnë nuk do t’i marrin këto dy paga dhe nëse nuk qëndrojnë nuk do t’i vazhdohet kontrata. Kështu që t’i zhatazhonë. Pyetja e dytë” pse kandidatëve të testuar me shkrim në konkurset e ndryshme nuk ju kanë publikuar pikët të cilat ata i kanë pas në testin, po vetëm janë njoftuar me shkrim se mund të hyni në intervistë me gojë.

**znj.Liridona Bislimi:** Përsëritet të nderuar të pranishëm! Pyetje për drejtorin e ri: kam më shume se një vit që kam parashtruar kërkesë për një trafo elektrike në Drobesh, kemi pas diskutu me drejtorin e ndjerë, ka qenë edhe parcela e ndarë, mirëpo ende nuk kam marr asnjë përgjigje asnjëherë. Tani ka ardh edhe një kërkesë tjetër e re për një trafo tjetër, bëhet fjalë për tek “Lagjia e Kabashëve”, kërkesa është protokolu me datën 10.08.2021 edhe për këtë nuk kemi marr informata. Ju lutem nëse keni ndonjë informatë për këtë me njofto ose tani ose përmes emailit zyrtar. Edhe për drejtorin e inspeksioni e kame një kërkesë: tek banoret tek rruga Viti për në Pozharan, nëse ka mundësi të vendosen disa polic të shtrirë ose disa pengesa në rrugë për shkak se vozitësit po vozitin në mënyrë jo të kontrolluar, kane shqetësime për fëmijët që luan afër rrugës.

**z.Naim Pira, kryesues i Kuvendi komunal:** Një shkresë e tillë e di që më ka ardh në zyrën time, në Zyrën e Kuvendit, e me që behet fjalë për trafo elektrike, ju kam dërgu ministrisë përkatëse. Kam kërku intepretim të tyre, sepse në momentin që shpallen zgjedhjet 6 muaj para zgjedhjeve, pronat komunale nuk i kemi të drejt me i dhënë dhe mu me ka interesu si kryesues, a kemi të drejtë me i dhënë, dhe përgjigjen që kame marr u përgjigj që nuk kemi të drejtë me dhanë e për këtë arsye nuk e kemi sjell në kuvend.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Bekim, katallogu e parasheh jurist me qenë personi në fjalë, edhe mu me ka bërë kërkesë shumë dallash, se kryetari nuk i bëhet ankesë, janë procedurat në rast se konsideron që tu ka shkel një e drejtë, është komisioni për ankesa, këshilli për shërbyes civil, kur i shteren këto procedura vazhdon me gjykatë, e prandaj nuk i bëhet ajo ankesë kryetarit ose nënkryetarit. Unë nuk po du me thanë a ka pas të drejtë apo jo, të drejtën duhesh me ndjek vetëm me rrugë ligjore që janë përcaktu me ligj. Raporti i auditimit, 63 kontrata të punës nuk ka kuvend që nuk e kemi shqyrtu, e kemi informacionin shumë të mirë në mungesë të shpalljes të konkurseve na ka shti me marr me kontrata mbi veper tani nuk e di numerin po nuk eshte blerje e votës. Hidrocentralin besoj që e ka të gjitha dokumentacionin në rregull, se për ndryshe nuk kish muj me fillu. Valbona, besoj që ata që ta tha kryesuesi edhe atë e thamë unë. Nuredin, një kandidat për këshilltar të kuvendit komunal që i ka kalu një a po dy mandate, me i dhënë ultimatum që me ndal mbrojtje të një lokaliteti, me thanë na nuk e marrim ujin prej aty, besoj që nuk të shkon për këshilltar kjo, sepse është ultimatum kjo. Me kërku me than ujin me pru që me qenë i pijshëm, nuk ka këshilltar këtu që nuk thotë këtë. Për kanalizimet, të gjitha ato mbeturina që na e kemi një kompani e cila merret me mirëmbajtjen e kësaj, ka qenë dashur të lajmërohet Drejtoria për Shërbime Publike dhe të lajmërohet kompania. Thave që rruga me e dëmtuar në regjion të Gjilanit nuk ka.

Nuk qëndron kjo, sepse aty del edhe me makina, është rruga e dëmtuar, ama jo siç thu ti. Zekria, besoj që drejtori e shikon mundësin për kontejnerat. Remzi, sa i përket publikimit të poenëve, nuk e di këtë është çështjen e komisionit. Liridona, besoj që e morre përgjigjen nga kryesuesi.

**z.Skender Ahmeti, drejtori i inspeksionit:** Përsëritet të nderuar të pranishëm! U paraqiten disa çështje për drejtorin e inspeksionit, si ajo nga z.Bekim Azizi, çështje e inspektorit të pronës. E kemi ngrit si çështje shqetësuese, që me një formë një pozicion që unë mendoj inegzistent: udhëheqës për inspektimin në inspeksion. Pse athu kjo, për shkak se Zyra e Personelit ka bërë tejkalim të autorizimeve ligjore, që unë mendoj që ka bërë shkelje ligjore, për shkak se ai vend që ka qenë që 40 vite, inspektor i pronës, është shndërruar ose zëvendësuar me një udhëheqës për inspektimin e pronës. Unë e kam kontestu edhe tani e kontestoj, edhe sot katalogu i ri që zyra e personelit thirren, që kanë bazë juridike, është përgatit me Ligjin e Pagave dhe si i tillë e kemi pa deri tash se edhe bazë umbospersonit, ai Ligj i Pagave është inegzistent, që fatkeqësisht na kemi pas punë krejt me Ligjin e Pagave, po nuk është në fuqi dhe si i tillë nuk ekziston dhe këta që thirren si bazë juridike, Zyra e Personelit, unë e kontestoj dhe nuk ka bazë, dhe për këtë pozicion, unë kam bërë ankesë në Këshillin Mbikëqyrës të Pavarur të Republikës së Kosovës. Pres përgjigjen nga ai këshill dhe unë e mbroj këtë çështje, sepse udhëheqësi për inspektime si person mu nuk me pengon, po si pozicion me ka pengë dhe si pozicion nuk e kam pranë dhe si të tillë e them publikisht këtë para juve dhe ku do që ka nevojë, edhe në institucionet tjera, edhe gjyqësore, edhe prokuroriale jam në gjendje me thanë këtë, prandaj si të tillë nuk e kam pranë edhe derisa të jam unë drejtor i inspeksionit, këtë pozicion nuk e pranoj. Po të shkruhet inspektor i pronës dhe udhëheqës i inspektimeve, nuk ka kurrëfarë problemi. Tash nëse e kemi ndonjë problem që na del në teren, unë nuk muj me qit asnjë pozicion nuk muj me qit inspektorin sanitar, as të ajtis, as të ambientit, prandaj si pozicion u mbyll, për këtë ka bërë ankesë inspektor i ndërtimit, prandaj si të tillë ka pas qëndrim dhe e mbajt qëndrimin deri sa të jam aty. Pyetja a dytë ishte nga z.Ali Bajrami. Jemi shumë të sfiduar me pandemi, për shkak se edhe kemi shumë çështje me të cilat po ballafaqohen qytetarët tonë, kërkojnë intervenime të ndryshme. Ka raste ku qytetari vjen me grip e të rrezikon edhe ty, d.m.th kemi lloj lloj sfide, ndërsa tash me masat e reja do të jemi shumë të ngarkuar edhe në orët e mbrëmjes, edhe ditëve të vikendit, edhe pse qeveria e ka marrë një listë prej 85 inspektorëve, unë nuk besoj që kanë përvojë ata, po ta shohim qysh po funksionon. Pyetja tjetër ishte nga Liridona Bislim: në rrugën Viti-Pozharan të vendosen policë të shtrirë. Ne si inspektorat vetëm japim pëlqime, nëse e shohim që është rrezik situata dhe e dimë që ajo gjendje është e rëndë aty, kanë qenë disa pengesa aty që janë vendos pa lejen e inspektorëve, i kemi detyru me i heq, ndërsa tash kemi kërku nga kompania që të vendosen në tri udhëkryqet, në tri rrugët sinjalizuese: Pozharan, Drobovë, Sadovinë edhe në Viti, e kudo që të ketë nevojë.

**z.Remzi Salihu:** Nënkryetari tha: duhet të jemi të përgjegjshëm! Kur t'i konvenon bën pyetje e kur nuk i konvenon, mos bën pyetje. Tash unë nuk po e di qysh e ka kuptuar këtë, por në fillim e thash, si pyetje kam menduar të ja bëja kryetarit, po, po ja bëjë drejtorit të financave, sepse kryetari është shef i shefit. Pra, ishte pyetje për mos pagesën e punëtorëve që e ceka në pyetjet me nalt.

**z.Jakup Demiri:** Sheqtesimi im është tek Hidrocentrali në Binçë, për shkak që unë kam qenë, e kam vizituar para dy tri jave dhe gjendja është kjo, shife në foto, mundemi me shku me e pa.

**z.Skender Ahmeti, drejtori i inspeksionit:** Ministria e Planifikimi Hapësinorë, prandaj ne nuk jemi kompetent për këtë çështje, kjo është e nivelit qendror edhe dokumentacionin e ka rregulluar atje, gjendja është ashtu siç është.

**Kryesuesi z. Naim Pira:** Për seancën e shtatë të rregullt të Kuvendi Komunal të Vitisë, kemi para rendin e ditës. Po tani pika e dytë e rendit të ditës u terjk, kemi vetëm këtë :

## **Rend dite**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik, projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2022.

z.Berat Zuka, zyrtar financiar, bënë prezantimin e propozim vendimit për shfrytëzimin e rezervave komunale dhe e arsyeton këtë propozim vendim.

z.Bekim Azizi, pyetje shitesë rreth këtij propozim vendimi.

**z.Ali Bajrami:** Ne si grup parlamentar, do te jemi pro këtij propozim vendimi.

**z.Jakup Demiri:** Pasi që janë paret e ndamë, nëse janë për rritje të kapacitet, ne e mbështesim pa rezervë.

z.Ibrahim Rama, drejtor i financave, bënë sqarimin e këtij propozim vendimi.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit:** Qes në votim për miratim rendin e ditës, me propozim vendimin e ekzekutivit, i cili u propozua tani.

Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e KK-së**

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Hapi debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

**z.Zekirja Zuka:** Tek faqja nr. 9, aty ku kam thanë që kryetari i nëndegës së LDK-së në Smirë është zgjedh Graniti, këtu gabimisht e kam thanë, sepse kryetari është zgjedh Floren Ymeri.

**Kryesuesi z.Naim Pira** E hedh në votim procesverbalin me këtë vërejtjen e Zekirjas. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbal.

Pika e dytë e rendit të ditës:

### **2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitise për vitin 2022**

Kryesuesi bënë prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës dhe hapi debat për diskutim

**z.Jakup Demiri:** Pyetje! Për këtë vit: sa është përmbush plani i punës së kuvendit? Në qershor nuk kemi mbajt seancë. Sa janë përmbush planet e komiteteve të ndryshme ne katër vjet e kalume, ku ka ngecje që të shohim, që plani i ri çka duhet të ndryshohet? Komisioni i emërimit e rrugëve nuk ka pas asnjë takim.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit:** Plani i punës së Kuvendit është zbatu qind për qind, por disa drejtori nuk kanë pas pika, ndërsa sa u përket komiteteve, janë të obliguar me i sjellë informatat, e ku unë gjithmonë ju kam sjellë informatat në kuvend.

**z.Bekim Azizi:** Na këtë si plan duhet të kemi të parapamë, që t'i japim mundësinë edhe ekzekutivit që ta dinë se kuvendi e ka planin e vetë.

**z.Naim Pira, kryesues i kuvendit:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, po e qes në votim për miratim. Me votat e të gjithëve që ishin prezent, u miratu edhe kjo pikë.

**Si pikë e tretë e rendit të ditës:**


### **3. Propozim vendim për shfrytëzimin e rezervave komunale**

E prezantoj me parë, z.Berat Zuka, nëse nuk keni tjetër sen për të shtu, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë seancë.

Mbledhja përfundoj me punë në ora 11:40 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

**PROPOZIM VENDIM  
PËR PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2022-2024**

**Neni 1**

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin e „ PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË 2022-2024 “

Duke u bazuar në QARKOREN BUXHETORE 2022/02 të datës 05.08.2021 të lëshuar nga MFPT-ja me nr 1206/2021 ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2022-2024.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „ PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2022-2024 “ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

**Neni 3**


Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES KRYETARI I KOMUNËS  
Sokol Haliti





# KOMUNA E VITISË

## PLAN BUXHETI 2022 - 2024


*Drejtori i drejtoris për FEZH*

*Ibrahim Rama*

*Shtator 2021*

*Kryetari i Komunës*

*Sokol Haliti*



## PLAN BUXHETI 2022-2024

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i politikës ekonomike që ka në dispozicion qeveria komunale, dhe si i tillë ai pasqyron prioritetet e saja zhvillimore. Derisa buxheti rregullon të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal të caktuar, procesi buxhetor është i vazhdueshëm dhe përsëritet çdo vit. Komuna në muajin qershor ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve (KAB-i), një dokument planifikues afatmesëm që synon të përmirësojë parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e buxhetit, duke përfshirë buxhetin e vitit të ardhshëm fiskal dhe parashikimet buxhetore edhe për dy vitet fiskale të tjera, kur hartohet buxheti vjetor, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve i nxjerr qarkoret buxhetore 1 dhe 2 etj, që japin kufijt fillestar, informata dhe udhëzime rreth strukture së shpenzimeve në fonde burimore dhe kategori ekonomike për vitin e ardhshëm fiskal dhe parashikimet për dy vitet pasuese, përcaktojnë procesin e bashkërendimit midis organizatave buxhetore dhe Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve. Në bazë të këtyre propozim-buxheteve, Ministria e përgatitë Propozim-Buxhetin e Kosovës dhe Projektligjin për ndarjet buxhetore dhe ia dorëzon ato për shqyrtim qeverisë. Qeveria duhet ta paraqesë projektligjin për shqyrtim në Kuvend deri më 31 tetor të vitit aktual fiskal.

Organizatave buxhetore të nivelit lokal - Komunat duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- **30 Qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,**
- **30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2022-2024 nga Kuvendi Komunal,**
- **30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve dokumentet si në vijim:**
  - **Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).**
  - **Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2022-2024, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.**
  - **Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB-se dhe PIP):**
    - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2022-2024 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
    - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2022 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2023 dhe 2024 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
    - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB-se, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
    - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator.

Përgatitja e buxhetit 2022-2024 ka filluar nga muaji maj i vitit 2021, konform LMFPP dhe Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Këtë periudhë kohore e kanë përcjellë dy qarkore buxhetore të lëshuara nga MF-ja, qarkorja e parë buxhetore 2022/01, të datës 14.05.2021 dhe qarkorja e dytë buxhetore 2022/02 të datës 05.08.2021 të lëshuar nga MFPT-ja.

Me qarkoren buxhetore 2022/02 jemi njoftuar për strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2022 si dhe parashikimet për vitin 2023 dhe 2024.

Kufijt nëpër kategori ekonomike janë të përcaktuar me qarkoren buxhetore 2022/02 kështu:

### Paraqitja e buxhetit sipas kategorive ekonomike

| Paraqitja e buxhetit për vitin 2022 sipas kategorive ekonomike |                        |                   |               |
|----------------------------------------------------------------|------------------------|-------------------|---------------|
| nr.                                                            | Kategorit ekonomike    | Shuma             | %             |
| 1                                                              | Pagat dhe shtesat      | 7,618,305         | 58.29         |
| 2                                                              | Mallrat dhe Shërbime   | 2,092,704         | 16.01         |
| 3                                                              | Shpenzime Komunale     | 320,000           | 2.45          |
| 4                                                              | Subvencione, transfere | 360,000           | 2.75          |
| 5                                                              | Shpenzimet Kapitale    | 2,678,486         | 20.49         |
|                                                                | <b>TOTALI</b>          | <b>13,069,495</b> | <b>100.00</b> |

Shuma e grantit qeveritar është 12,081,627 €, të hyrat vetanake 987,868 € totali buxhetor 13,069,495 €.

Plan buxheti i vitit 2022 është përgatitur në bazë të Statutit të Komunës së Vitisë, duke bërë shpërndarjen e fondeve nëpër drejtori / programe dhe nënprograme.

Në qarkoren e parë buxhetore 2022/01 paraqiten udhëzimet e para: kalendari kohor, kufijt fillestar të përgatitjes së KAB-it Komunal dhe fillimit të përgatitjes së Draft (projekt) Buxhetit Komunal për vitet 2022-2024. Në qarkoren e dytë buxhetore 2022/02 janë dhënë kufijt e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike (duke përfshirë shpenzimet e pagave dhe shtesave, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale) për vitet 2022-2024.

Buxheti komunal për vitin fiskal 2022-2024 do të paraqitet sipas 5 kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara në pajtim me rregullat e thesarit:

1. Paga e shtesa,
2. Mallëra dhe shërbime,
3. Shpenzime komunale,
4. Subvencione e transfere, si dhe
5. Shpenzime kapitale

| KUFIJT BUXHETOR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITET 2021-2024 |                   |                   |                   |                   |
|----------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Kategorit ekonomike                                            | 2021              | 2022              | 2023              | 2024              |
| Paga e shtesa                                                  | 7,437,105         | 7,618,305         | 7,656,397         | 7,694,679         |
| Mallëra e shërbime                                             | 1,918,949         | 2,092,704         | 2,162,237         | 2,188,403         |
| Shpenzime komunale                                             | 320,000           | 320,000           | 328,263           | 341,393           |
| Subvencione e transfere                                        | 350,000           | 360,000           | 390,133           | 417,351           |
| Shpenzime kapitale                                             | 2,464,632         | 2,678,486         | 3,184,248         | 3,751,332         |
| <b>Totali</b>                                                  | <b>12,490,686</b> | <b>13,069,495</b> | <b>13,721,278</b> | <b>14,393,158</b> |

Ndryshimi i kufijëve buxhetor për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021

|                 |                             |                   |       |                   |
|-----------------|-----------------------------|-------------------|-------|-------------------|
| ✓               | Granti i Përgjithshëm ..... | (rritje 274,318)  | ..... | 4.850,186         |
| ✓               | Granti i Arsimit .....      | (rritje 177,873)  | ..... | 5.605,057         |
| ✓               | Granti i shëndetësisë ..... | (i njëjt - )      | ..... | 1.628.384         |
| ✓               | Të hyrat vetanake .....     | (rritje 126,618)  | ..... | 861,250           |
| Gjithësejt..... |                             | ( rritje 578,809) | ..... | <b>13.069,495</b> |

Dallimi i buxhetit në mes të viteve 2021 dhe 2022


| nr. | Kategorit ekonomike | 2021              | 2022              | diferenca      |
|-----|---------------------|-------------------|-------------------|----------------|
| 1   | Paga e mëditje      | 7,437,105         | 7,618,305         | 181,200        |
| 2   | Mallra e shërbime   | 1,918,949         | 2,092,704         | 173,755        |
| 3   | Shpenzime komunale  | 320,000           | 320,000           | -              |
| 4   | Subven. e transfere | 350,000           | 360,000           | 10,000         |
| 5   | Shpenzime kapitale  | 2,464,632         | 2,678,486         | 213,854        |
|     | <b>Totali</b>       | <b>12,490,686</b> | <b>13,069,495</b> | <b>578,809</b> |

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhet nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare** (granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetësisë),
2. **Të hyrat vetanake komunale.**

**Buxheti i Komunës në vitet 2020 – 2024**

| Buxheti sipas viteve |                      |
|----------------------|----------------------|
| <b>Viti 2020</b>     | <b>11,305,491.00</b> |
| <b>Viti 2021</b>     | <b>12,490,686.00</b> |
| <b>Viti 2022</b>     | <b>13,069,495.00</b> |
| <b>Viti 2023</b>     | <b>13,721,278.00</b> |
| <b>Viti 2024</b>     | <b>14,393,158.00</b> |



Buxheti i Komunës së Vitisë si tërësi ka shënuar rritje në vitin 2022 prej 578,809 € ose prej 4.63 %. Në vitin 2021 shuma e buxhetit është prej 12,490,686 €, në vitin 2022 shuma e buxhetit është prej 13,069,495 €, në vitin 2023 shuma prej 13,721,278 në vitin 2024 është prej 14,393,158,€.

Viti 2022 në krahasim me vitin 2021 ka rritje prej 4.63 %, viti 2023 në krahasim me vitin 2022 ka rritje prej 4.99% dhe viti 2024 në krahasim me vitin 2022 ka rritje prej 10.13 %.

Rritje është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm prej 274,317 €, në grantin specifik të arsimit dhe shkencës prej 177,873 €, grantin specifik i shëndetësis është i njëjt, , kurse total grantet kanë rritje prej 452,190 €.

Të hyrat vetanake komunale kanë rritje në krahasim me vitin 2021 në shumë prej 126,618 € ( 987,868 – 861,250 ) €.

Në materialin e paraqitur kemi planifikimin e buxhetit për të gjitha linjat buxhetore, si: administrata komunale, arsimit dhe shkenca, shëndetësia dhe mirëqenja sociale dhe shërbimet sociale. Këtu janë përdorur të gjitha kriteret të cilat janë të parapara me LMFP, për ndarjen e buxhetit, kriteri funksional, organizativ, ekonomik e burimor, duke e respektuar edhe kodin e nënzërave pesë shifror në sistemin e BDMS-së.

Ndarja e mjeteve të **grantit të përgjithshëm** duke kalkuluar në nr e popullsis sipas regjistrimit të popullsis të vitit 2011 komua jonë ka numër të banorëve prej 46,987 banor ,bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (I) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (II) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (III) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (IV) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%). (Shif QB2022/01 faqe 11)

Në kuadër të programit të arsimit kemi ndarjen sipas katër nënprogrameve në:

1. Administratë ( financohet nga granti i përgjithshëm),,
2. Arsimi parashkollor / çerdhet,
3. Arsimi fillor,
4. Arsimi i mesëm.

Në programin e **arsimit** aplikohet sistemi i hapur i financimit duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT-it për vitin 2021 buxhet për çdo shkollë, formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2020/2021;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHT-it);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
